



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DHE SPORTIT

Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve

MBI PROGRAMIN E TRAJNIMIT TË SHKOLLËS KOMBËTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE (ENA)

Qeveria e Republikës Franceze njofton se Shkolla Kombëtare e Administratës Publike (The Ecole Nationale d'Administration, ENA) dhe Institutet Rajonale të Administratës Publike (IRA) kanë shpallur fushatën e përzgjedhjes për vitin 2014-2015 për ciklet ndërkombëtare afatshkurtër dhe afatgjatë të trajnimit (international cycles).

Shkolla Kombëtare e Administratës Publike (The Ecole Nationale d'Administration, ENA), e themeluar më 9 tetor 1945, synon: standardizimin për rekrutimin e nëpunësve civilë nëpërmjet konkurrimit dhe sigurimin e një trajnimi profesional për ngritjen e tyre në nivelet më të larta të shërbimit publik. Qëllimi i Shkollës Kombëtare e Administratës Publike është të funksionojë sipas standardeve bashkëkohore Evropiane me të gjitha format të reja të menaxhimit publik. Evropa tani paraqet një fushë e natyrshme shërbimesh të veprimit civil. Një pjesë e aktiviteteve të ENA-së janë të grupuara në Strasburg dhe realizohen mbi bazën e përvojës punës.

Një nga parimet themelore të cikleve ndërkombëtare të trajnimit është shkëmbimi i pikëpamjeve dhe i përvojës, duke i alternuar ato në klasë. Pjesëmarrja në kurset e trajnimit sipas programit "International Cycles" i mundëson studentët e huaj dhe ata vendas për karrierë në radhët më të larta të Administratës Publike që përfshin: Këshillin e Ministrave, Gjykatën, Inspektoratet e Përgjithshme dhe ato të Specializuara, shërbimet e promovimit për këshilltarë dhe administratorë që punojnë në Paris ose jashtë vendit.

Shkolla Kombëtare e Administratës Publike (ENA) është një qendër administrative shtetërore dhe ofron një shumëllojshmëri programesh për studentët e huaj të shërbimit civil. Konkretisht:

1. Trajnime afatshkurtra intensive (1 deri 4 javë) mbi tema të specializuara. Këtu përfshihen cikle ndërkombëtare të specializuara në administratën publike (CISAP). Këto trajnime mbahen kryesisht në Paris për ciklet e punës intensive;
2. Trajnime të përgjithshme ose të specializuara afatgjata (8 dhe 16 muaj), të cilat mbahen në Strasburg dhe përfshijnë: kurse ndërkombëtare të trajnimit afatgjatë (CIL), ato të avancuarat (CIP), si dhe kurset ndërkombëtare e trajnimit 8-mujore IRA (CiIRA); Trajnimet ndërkombëtare afatgjata (CIL) mund të plotësohen me një program Master në fushën e administratës e përgjithshme publike, ose asaj të komunikimit të institucioneve publike, ose në fushën e politikave publike në Evropë. Kursi ndërkombëtar i avancuar i trajnimit (CIP), mund të plotësohet gjithashtu me një program MASTER në dy fusha të rëndësishme:
 - Administratat dhe çështjet ndërkombëtare;

- Administratat dhe menaxhimi publik.

Kushtet për pranim për kurset afatshkurtra dhe afatgjata Aplikanti duhet:

- Të jetë nëpunës civil të administratës publike;
- Të ketë marrë letrën e miratimit nga shkolla për programet CISAP, CIL, CIP dhe CiIRA;
- Të ketë përfunduar minimumin katër vite studimi të nivelit universitar (bachelor) si dhe 1 vit në programin Master;
- Të ketë jo më pak se tre vite përvojë profesionale;
- Të ketë miratimin e institucionit përkatës në të cilin kandidati punon;
- Të ketë njohuri shume të mira në fushën e historisë, gjeografisë dhe ekonomisë si dhe për institucionet politike dhe administrative;
- Të ketë interes për çështje sociale me të cilat bota po përballlet në ditët e sotme;
- Të ketë njohuri shume të mira të gjuhës frënge. Aplikantët, të cilët do t'i nënshtrohen testit të gjuhës frënge do t'i referohen faqes:
<http://www.ena.fr/index.php?/fr/formation/Cycles-internationaux/tests-de-selection>; Në kuadër të programeve Ena / IRA, kandidatët do të testohen edhe për sistemin administrativ francez dhe për institucionet evropiane.

Procedurat e aplikimit realizohen përmes Ambasadës Franceze në Tiranë. Pala franceze parashikon bursë shtetërore për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit dhe të jetesës, por vetëm në rastet kur kandidati aplikon në Ambasadën Franceze në Tiranë. Aplikantët që nuk përfitojnë bursë do t'i mbulojnë vetë tarifat e shkollimit dhe të akomodimit.

Përzgjedhja e kandidatëve për në kurset ndërkombëtare të trajnimit ENA/IRA bëhet nga qendra administrative shtetërore franceze.

Përshkrimi i detajuar i fushave studimore, afateve, mënyrës së aplikimit, kushteve për përfitimin e bursës, si dhe informacione të tjera gjenden në adresat e internetit të ENA-s në vijim:

<http://www.ena.fr/index.php?/en/content/download/333/24061/file/Brochure%20CI%202014%20ENG.pdf>;

<http://www.ena.fr/index.php?/en/formation/International-cycles/CISAP>;

http://www.ena.fr/index.php?/en/formation/International-cycles/node_3701;

<http://www.ena.fr/index.php?/en/formation/International-cycles/Masters-degrees-in-public-administration/Master-s-degree-in-general-public-administration>;

<http://www.ena.fr/index.php?/en/formation/International-cycles/master-com-ap>;

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE